

## Panairi Work & Study 2023

Personeli akademik, ndihmësakademik dhe administrativ i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", mirëpriti në Panairin Work&Study 2023, zhvilluar në Pallatin e Sportit, maturantë të shumtë të cilët u informuan mbi programet e studimit që ofrohen, mundësitë e financimit për regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve, praktikat profesionale, programet e shkëmbimit studentor dhe hapësirat e dedikuara për zhvillimin e tyre shkencor, profesional e kulturor.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të këshillimit të karrierës dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, IAL, Dhomën e Tregtisë Tiranë, ZVA Elbasan dhe Bashkinë Elbasan.



